



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24.1.2025

Nr: 32

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË MINISTRISË
PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME, PËR PERIUdhËN 17 JANAR – 18 JANAR
2025**

Sot, më datë 24.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për periudhën 17 janar deri më 18 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 17-18 janar 2025, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

- Konferencë/sumit, “*Takim i Ministrave të Jashtëm në formatin: Ukrainë-Evropa Juglindore*”, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 17.1.2025,
- Kulturë, “Aktivitet me rastin e 557-vjetorit të ndarjes nga jeta të Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu” raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 17.1.2025,

Data: 24.1.2025 Nr: 32
Ora: 13:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për periudhën 17 janar – 18 janar 2025”

- Kulturë, “Pjesëmarrja e Ambasadorit të RSH-së në Shkup Z. Denion Meidani në ceremoninë e vendosjes së kurorave me lule në statujën e Skënderbeut”, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 17.1.2025,

Nëpërmjet email-it të datës 22.1.2025, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 24.1.2025, ora 13:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: “Në lidhje me 3 aktivitetet raportuara nga MEPJ e cilësuar si të ndaluara nga ndërfaqja e raportimeve sqarojmë se të 3 këto aktivitete janë zhvilluar jashtë vendit me ftesë të palëve pritëse dhe nuk janë organizuar nga MEPJ apo përfaqësitë diplomatike. Pas komunikimeve që MEPJ ka pasur me KQZ është sqaruar që aktivitete të tilla nuk është e nevojshme të raportohen.

Vonesa në raportim ka ardhur si pasojë e paqartësisë nëse duhen raportuar ose jo aktivitete të kësaj natyre”.

Për sa më sipër, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se veprimtaria publike dhe në referim të pikës 3, të nenit 5, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, parashikohet se raportimi në NRI për një veprimtari publike duhet të bëhet jo më vonë se 5 (ditë) përpara datës së planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Raportimi bëhet nga përveprimtari të cilat organizohen ose bashkëorganizohen nga institucioni publik raportues. Nuk raportohen veprimtari ku institucioni publik, apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI